



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2142 Prot.

Tiranë, më 17.09. 2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 107 dt. 17.09. 2025

“PËR

**HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË
 KËRKIMIT, PROJEKTEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE”**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i) të nenit 38, nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, nenit 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Përhershëm, në Nivel Institucioni, të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, nenit 23 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST, Senati Akademik me vendim qarkullues

VENDOSI:

1. Hapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, me këtë përbërje:
 - 5 (pesë) anëtarë nga personeli akademik i UST-së, që i përkasin kategorisë “Profesor”;
 - 1 (një) anëtar përfaqësues i stafit administrativ;
 - 1 anëtar përfaqësues i studentëve;
2. Regjistrimi i kandidatëve të kryhet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së nga data 17.09.2025 deri në 25.09.2025
3. Kandidatët e interesuar në momentin e aplikimit duhet të cilësojnë qartë emrin e komisionit ku vetëkandidojnë.

4. Sekretari i Senatit Akademik të përpilojë “Njoftim” për të gjithë të interesuarit me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi drejtuesit e njësive kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

